



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS/ SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI 2008

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
I. FUNKSIONIMI I INSTITUCINIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT	4
Baza ligjore ne fuqi.....	4
Parimet mbi te cilat funksionon Organi Shqyrtues i Prokurimit	5
Ngritja dhe fillimi i punës së institucionit(OSHP-së)	6
Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit	6
Struktura dhe Organogrami i OSHP-së	7
Marrëdhënia me publikun	8
Buxheti.....	8
II. SHQYRTIMI I ANKESAVE TË PROKURIMIT	9
Tabela e Shqyrtimit të ankesave sipas Autoriteteve Kontraktues Gusht-Dhjetor 2008	10
Krahasimi i lëndëve të shqyrtuara.....	12
Shqyrtimi i vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik	13
Raporti gjashtë mujor i punës së Panelit Shqyrtues të KRPP-së.....	14
III. OBJEKTIVAT E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2009	14
Konsolidimi i Institucionit	15
Zbatimi i strategjisë së komunikimit	16

HYRJE

Institucioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), i krijuar ne bazë të rregullores së UNMIK-ut 2007/20, të datës 06.06.2007, “Për Prokurimin Publik në Kosovë”, i ndryshuar, është një kontribut mjaft i rëndësishëm në përpjekjet për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë për administrimin e mirë të fondeve publike nga njëra ane, dhe rritjen e besimit te operatorët ekonomik për një konkurim të drejt dhe të paanshëm, nga ana tjetër, ndërkohë që kërkesat për rritjen e transparencës dhe barazisë në Prokurimet Publike është edhe një nga kushtet e marrëveshjes se Asocim-Stabilizimit të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Funksioni bazë i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është garantim i zbatimit të Ligjit për Prokurim Publik dhe Ligjit mbi dhënien me koncesion dhe i detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Si institucion i pavarur i mandatuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me kompetenca shqyrtimi dhe hetimi në fushën e Prokurimit Publike dhe të Koncesioneve, Organi Shqyrtues i Prokurimit është një mundësi më shumë për gjithë Operatorët Ekonomik apo çdo pale të interesuara, për të paraqitur ankesat e tyre kur vërejnë shkelje të ligjshmërisë së dispozitave të LPP-së, pabarazi dhe diskriminim nga veprimi dhe mosveprimi i kundërligjshëm i Autoriteteve Kontraktuese të Administratës Publike dhe Ndërmarrjeve Publike ne procedurat përkatëse të prokurimit.

Me rekomandimet që ai nxjerr në përfundim të çdo procesi, që kryhet në bazë të ankesave të marra apo me iniciativën e tij, Organi Shqyrtues i Prokurimit tërheq vëmendjen mbi mangësitë apo problemet që mund të identifikohen, orienton institucionet e Administratës Publike në vendimmarrje të drejt, si dhe synon të ofroj zgjidhje konstruktive teknike dhe legjislative që sigurojnë mbarëvajtjen e procedurave dhe parandalimin e rasteve abuzive.

Ndonëse një institucion i ri, me veprimtarin e tij konkrete, Organi Shqyrtues i Prokurimit po rrit gjithnjë njohjen dhe legjitimitetin institucional, brenda një periudhe jo më shumë se 5 mujore te aktivitetit në vitin 2008, gjatë kësaj periudhe Organit Shqyrtues të Prokurimit ju drejtuan 179 ankesa, 142 të cilat u përmbyllen me sukses brenda 31 dhjetorit 2008.

I. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

Baza ligjore ne fuqi

Organi Shqyrtues i Prokurimit ushtron aktivitetin e vet mbështetur në:

-Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/20, të datës 06.06.2007, “Për Prokurimin Publik në Kosovë”, i ndryshuar,

-Ligjin nr. 02/L-44, të datës 03.10.2005, “Për Procedurën e dhënies së Koncesioneve”,

- Ligjin nr. 02/L-28, të datës 25.07.2005, “ Për Procedurën Administrative”,

- Legjislacionin dytësor mbi Prokurim Publik

- Rregullores se punës së OSHP-së

OSHP-ja është institucion i pavarur, në mbrojtje të operatorëve ekonomik vendor apo të huaj nga veprimet dhe mosveprimet të paligjshme të autoriteteve kontraktuese në administratën publike si dhe në ndërmarrjet publike në një procedurë prokurimi apo koncesioni.

Karakterit i pavarur i OSHP-së bazohet në procesin e vendimmarrjes dhe reflektohet në faktin se:

- Anëtarët e OSHP-së zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në një mandate 5 dhe 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër .
- Nuk janë pjesë e asnjë forcë politike
- Nuk angazhohen në asnjë organizatë shoqërore, ekonomike dhe tregtare dhe
- Nuk kanë lidhje varësie me asnjë institucion qendror.

Mbështetur në legjislacionin e mësipërm, Organi Shqyrtues Prokurimit ka këto kompetenca:

- Të shqyrtojë procedurat administrative në prokurimin publik dhe dhënien me koncesion brenda kufijve shtetërorë të Republikës së Kosovës,
- Të hetojë ne bazë të ankesave të pranuar apo me iniciativën e tij veprimet apo mosveprimet të kundërligjshme ose të pa rregullta të autoriteteve kontraktuese
- Të rekomandojë masa korrigjuese,

- Të raportoj direkt në Kuvendin e Republikës së Kosovës për aktivitetin dhe problematikat që trajton, nëpërmjet analizës vjetore, me kërkesën e Kuvendit konform nenit 115 të LPP-së.

Gjatë hetimit-shqyrtimit të ankesave ,OSHP ka të drejtë:

- Kryen hetime dhe shqyrtim të procedurave të prokurimit me qëllim që të përcaktohen faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla,
- Të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoriteti publik që të dorëzojë ,paraqesë ose mundësoj qasje në të dhënat, informacione,dokumente që konsiderohen të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave të shqyrtimit të prokurimit,
- Të marr çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin-ankesën,
- Të nxjerr një urdhër ndaj çdo personi për tu paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe te jap dëshmi ,
- Të thërras për një seancë dëgjimore në zyrën e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), zyrtarin e prokurimit të autoritetit kontraktues si dhe përfaqësuesin e operatorit ekonomik.

Refuzimi i nëpunësve civil, i përfaqësuesve te autoriteteve kontraktuese ose i autoriteteve publike për të respektuar vendimin e paneleve shqyrtuese ose bashkëpunuar me OSHP-ën, përbën shkak që të ndërmarr masat ndaj tyre, konform nenit 118 të LPP-së.

Parimet mbi te cilat funksionon Organi Shqyrtues i Prokurimit

Gjatë ushtrimit të funksionit të sajë OSHP udhëhiqet nga parimet e përgjithshme , të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës se Kosovës, Ligjin e Procedurës Administrative dhe në zbatim të plot të Ligjit Prokurimit Publik siç janë:

- Paanshmëria,
- Transparenca
- Mosdiskriminimi dhe barazia në trajtim,
- Pavarësis
- Konfidencialiteti,
- Profesionalizmi,
- Ekonomicitetin dhe Efikasiteti.

Organi Shqyrtues i Prokurimit punonë në frymën e bashkëpunimit të hapur dhe konstruktiv me të gjitha institucionet e angazhuara për ruajtjen e sistemit të prokurimit publike dhe dhënies me koncesion, duke përmendur në radhë të parë;Komisionin

Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Agjensioni i Prokurimit Publik (APP), Autoritetet Kontraktuese (AK) dhe Operatoret Ekonomik (OE).

Parimi themelor i punës së OSHP-së është transparenca nëpërmjet mjeteve të komunikimit me publikun, siç është ueb faqja e OSHP-ës, mjetet tjera të telekomunikimit si dhe ato të shkruara.

Organi Shqyrtues i Prokurimit siguron gjithashtu të drejtën për të informuar publikun dhe njëkohësisht mundëson kushte për marrjen e informacionit mbi dokumentet zyrtare në fushën që ajo mbulonë.

Ngritja dhe fillimi i punës së institucionit

Organi Shqyrtues i Prokurimit u emërua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 03-0739/130, të datës 30.07.2008. Kjo u pasua me vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës me Nr. 03/1080/10-651/2 të datës 29.09.2008, për miratimin e strukturës dhe Organogramit të OSHP-ës.

Në sajë të ndihmës së dhënë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për përsheptimin e procedurave të lirim të ambienteve të caktuar për OSHP-ën, ajo filloi punën me datën 01.08.2008, në zyret e ish Kishnicës, në rrugën "GARIBALDI" pa Nr. ku është aktualisht selia e këtij organi.

Përzgjedhja e stafit mbështetës te OSHP-së


Brenda muajit Janar 2009, Organi Shqyrtues i Prokurimit plotësoi pjesërisht organogramin me pesë (5) shërbyes civil të përzgjedhur sipas përshkrimit të vendeve të punës, të cilët janë me eksperiencë në fushën e prokurimeve, atë administrative dhe njohës të mirë të legjislacionit, ndërsa gjatë muajit mars 2009 OSHP, do të rekrutojë edhe tetë (8) shërbyes tjerë civil me çka do të plotësojë tetëmbëdhjetë (18) pozitat e lejuara prej Komisionit për Buxhet dhe Financa të Republikës së Kosovës .

Struktura dhe Organogrami i Organit Shqyrtues të Prokurimit

Në vazhdim po ju paraqesim në formë skematike - organogramin e institucionit të OSHP-së.



ORGANOGRAMI I ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT



Ky organogram hynë në fuqi menjëherë - nga dita e marrjes së të njëjtit.
Lidhur me zbatimin këtij organogrami do të kujdeset kryetari i OSHP-së.
Vërejtje: Ky organogram mund të pësoj ndryshime gjatë vitit 2009.

Kryetari
Hysni Hoxha

Marrëdhëniet me publikun

Marrëdhëniet me publikun konsiderohen si një element kyçë i punës të institucionit të ri të OSHP-ës si për të komunikuar rolin e sajë në garantimin e zbatimit të Ligjit për Prokurim Publik dhe dhënies me koncesion në mbrojtje të drejtave të ofertuesve, ashtu edhe për të institucionalizuar dialogun me grupet e interesit dhe publikun në përgjithësi në interes të menaxhimit sa më të mirë të buxhetit të Kosovës .

Ndonëse struktura e miratuar nuk përfshinë një sektor për marrëdhëniet me publikun, në gusht 2008, OSHP-ja ngarkoi përgjegjësin e sektorit të menaxhimit të personelit (Zyrtar i lart për pranimin dhe trajtimin e ankesave) dhe Asistencës ligjore që të kryejnë detyra të punonjësit të marrëdhënieve me publikun. Një nga këto angazhime është pranimi i ankesave dhe kërkesave të operatorëve ekonomik dhe dhënia e sqarimeve të nevojshme për plotësimin e ankesave me elementet e nevojshme që do të bënë më të lehtë trajtimin e tyre.

Buxheti

Ndër sfidat e një Institucioni i krijuar rishtazi, ka qenë edhe hartimi dhe zbatimi i buxhetit të miratuar në vitin e parë të funksionimit të tij.

Për vitin 2008, Buxheti i miratuar për Organin Shqyrtues të Prokurimit kap shumën prej 213,000.00 €. Ai është realizuar pothuajse tërësisht në mënyrë efikase, siç paraqitet në tabelën si në vijim.

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PASQYRA E BUXHETIT PER VITIN 2008

Kategoria ekonomike	Buxheti vjetor	Buxheti i alokuar	Shpenzimet	Fakt %
Paga dhe meditje	50,792.00	50,792.00	29,400.00	57.88
Mallra dhe shërbime	147,700.00	147,700.00	118,212.21	80.04
Shpenzime komunale	15,000.00	15,000.00	1,882.91	12.55
Totali	213,492.00	213,492.00	149,495.12	70.02

Gjatë vitit buxhetorë 2008, është bërë e mundur realizimi i prokurimeve, lidhja e kontratave duke siguruar ambient dhe kushte normale për funksionimin e OSHP-së.

II. SHQYRTIMI I ANKESAVE TË PROKURIMIT

Shqyrtimi i ankesave të palëve të interesuar (operatorëve ekonomik) që i drejtohen Organit Shqyrtues të Prokurimit, bëhet nga Panelet Shqyrtuese në përbërje prej një anëtari ose tre anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ndërsa në rastet kur lënda e cila është në shqyrtim, është e rëndësishme apo interesit të veçantë, paneli shqyrtues përbëhet prej pesë anëtarëve të OSHP-së. Paneli shqyrtues emërohet nga Kryetari i Organit Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së ankesave të parashtruara, Panelet Shqyrtuese duke u bazuar në nenet 102.1, 102.2 si dhe 112.2 të LPP-së, ekspertizat e eksperteve dhe seancave dëgjimore panelet shqyrtues nxjerrin këto vendime.

1. Aprovimin e aktiviteteve të prokurimit, kur autoriteti kontraktues nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së.
2. Rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, nëse komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues gjatë vlerësimit nuk i është përmbajtur kritereve të caktuara në dosjen e tenderit dhe nuk ka bërë vlerësim objektiv .
3. Anulimin e aktivitetit të prokurimit, atëherë kur autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të procedurave të prokurimit gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit.
4. Refuzimin e ankesave, atëherë kur ankesat janë të pa kompletuara, sepse operatorët ekonomik nuk ju kanë përmbajtur afateve për parashtrim të ankesës ose ka dështuar në ofrimin e sigurimit për ankesë.


Tabelën e Shqyrtimit të Ankesave sipas Autoritetit Kontraktues Gusht –Dhjetor 2008

Nr R.	Autoritetet Kontraktuese	Nr. i ankesave të pranuar	Nr. i lëndëve të shqyrtuara	Nr. i vendimeve të aprovuara	Nr. i vendimeve për rivlerësim	Nr. i vendimeve të anuluar	Nr. i Ankesave të Refuzuara
1	Kuvendi i R. se Kosoves	4	4	2	1	1	
2	M. Sherbimeve Publike	13	9	4	5		4
3	M. Arsimit, Shken. dhe Teknologjisë	16	11	4	4	3	5
4	M. Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	6	3			3	3
5	M. Transportit dhe Post-Telekomit	3	3	3			
6	M. Mjedisit, Planifikimit Hapës.	2	2	1		1	
7	Ministria e Drejtësisë	8	8	4	2	2	
8	M. Energjetikës dhe Min.	2	2	2			
9	M. Administrimit të Pushtetit Lokal	2	2	1	1		
10	M. Tregtisë dhe Industrisë	4	4	1	2	1	
11	Ministria e Shëndetësisë	5	4	3	1		1
12	M. Focave të Sigurise së Kosovës	2	2	2			
13	M. Punëve të Mbrend.	1	1	1			
14	M. Punëve të Jashtme	1	1	1			
15	M. Ekonomisë Financave	2	2	2			
16	Trupat Mbrojtëse të Kosovës	1					1
17	M. Bujqësisë, Zhvillimit, Rural	3	2	2			1
18	Shërbimi Policor i Kosovës	2	2	1	1		
19	Administrata Tatimore e Kosovës	8	7	4		3	1
20	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit	1					1
21	Agjencioni për Barazi Gjinore	1	1			1	
22	Enti Statistikor i Kosovës	1					1
23	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	2		1		1	

24	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor	2	2	2			
25	Universiteti Prishtinës	7	7	4	2	1	
26	Aeroporti i Prishtinës	4	3	2		1	1
27	KEK	10	10	6	2	2	
28	Agjensioni Veterinar	1					1
29	Drejtorati Kom. Arsimit Podujevë	1					1
30	PTK	6	5	4		1	1
31	KOST	1	1	1			
32	TERMO KOS	1	1	1			
33	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	1	1	1			
34	HEKURUDHAT E KOSOVES	2	2	1		1	
35	Kompania Regjionale për Menaxhim të Hedhurinave" UNITETI" Mitrovicë	1	1		1		
36	Zyra Rregullatorit të Energjisë	1	1		1		
37	QKUK	5	4	3	1		1
38	Shërbimi Doganor i UNMIK-ut	2	2	1		1	
39	Sptiali Rajonal i Gjakovës	1	1			1	
40	Qendra e Artistave të Kosovës	3	3	3			
41	KK. Gjilan	3	1	1			2
42	K.K. Prizren	7	6	4	1	1	1
43	K.K.Kamenicë	2	2	1		1	
44	K.K. Rahovec	3	3	2		1	
45	K.K. Viti	4	3	2		1	1
46	K.K. Frizaj	7	5	1	4		2
47	K.K. Klinë	3	2	2			1
48	K.K. Obiliq	1	1	1			
49	K.K. Istog	1	1		1		
50	K.K. Suharekë	2	2	1		1	
51	K.K. Hani i Elezit	1					1
52	K.K.Gjakovë	1					1
53	K.K. Zveçan	2					2
54	K.K.Pejë	1	1			1	
55	K.K.Kaqanik	1	1	1			
56	K.K. Dragash	1					1
Totali		179	142	84	30	30	35

Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë pesë muhorit të fundit të vitit 2008 ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsejtë 207 ankesa të palëve të interesuara – operatoreve ekonomik dhe autoriteteve kontraktuese, në të cilat pretendonin shkelje të ligjit ne vendimet e autoriteteve kontraktuese gjatë procesit të vlerësimit të aktivitetit të prokurimit .

Krahasimi i lëndëve të shqyrtuara 2007-2008



Afati për shqyrtimin e ankesave dhe nxjerrjen e vendimeve nga Paneli Shqyrtues sipas LPP-së kërkohet të jetë maksimum 35 ditë kalendarike nga dita e pranimit të ankesës. Nga gjithsejtë 207(179 të OE dhe 28 të AK) ankesa të parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Paneli Shqyrtues në asnjë rast nuk ka dështuar në shqyrtimin dhe nxjerrjen e vendimit brenda afati ligjor. Ligji i Prokurimit Publik gjegjësisht neni 114 parasheh se nëse parashtruesi i ankesës mendon se vendimi i Panelit Shqyrtues është në kundërshtim me fakte ose me ligjin, parashtruesi i ankesës mund të kërkoj nga Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtimin e vendimit në pajtim me ligjin e zbatueshëm për Procedurën Administrative .

Nëse bëhet një krahasueshmëri e ankesave të pranuar dhe të shqyrtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit me ato të Panelit Shqyrtues të KRPP-së, vërehet se Paneli Shqyrtuesi i KRPP-së për gjashtë mujorin e parë (Janar –Qershor) të vitit 2008 ka trajtuar 110 lëndë, ndërsa OSHP-ja vetëm pesë (5) muaj të vitit 2008 ka trajtuar 207 ankesa. Kjo tregon se me fillimin e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit tek operatorët ekonomik është rritur dukshëm besueshmëria ndaj OSHP-së në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore, gjë që në të ardhmen e obligon Organin Shqyrtues të Prokurimit që të punojë edhe më shumë në këtë drejtim.

SHQYRTIMI I VENDIMEVE TË AGJENCIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Organi Shqyrtues i Prokurimit në bazë të nenit 95.2 dhe 30A.6 të LPP-së nr.02/L-99 ka shqyrtuar gjithsejtë 28 ankesa kundër vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik , të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kërkesat e autoriteteve kontraktuese për të autorizuar përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe revokim të nenit 30A.4 të LPP-së .

TABELA E SHQYRTIMIT TË VENDIMEVE TË AGJENSISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Periudha: Gusht - Dhejtor 2008

Nr	Autoritetet Kontraktuese	Kërkesë e Autoriteteve Kont.	Revokim të Nenit 30 A.4	Procedur të Negociuar sipas Nenit 34	Nr. i Kërkesave të aprovuara të A.K.	Nr. i Kërkesave të refuzuara të Autorit. K.
1	PTK	4	3	1	4	
2	KEK	4	3	1	3	1
3	Aeroporti Prishtinës	1	1			1
4	QKUK	1		1		1
5	Admin. Tatim. Kos.	1	1		1	
6	Universiteti i Prisht.	3	2	1	3	
7	SHPK	1		1		1
8	M.Punëve te Brend.	1		1	1	
9	M. Sherb. Publike	1		1	1	
10	M.Trans.Pos.Telek.	7	1	6	6	1
11	M.Arsim.Shkenc.Tek.	1		1	1	
12	OSHP	1	1		1	
13	K.K.Shtime	1	1		1	
14	K.R.M. Ekoregjioni	1	1			1
Totali		28	14	14	22	6

RAPORTI GJASHTË MUJOR I PUNËS SË PANELIT SHQYRTUES TË KRPP-së

Duke pasur parasysh faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit ka filluar të punojë me datën 01.08.2008, bashkangjitur me këtë ju përcjellim edhe raportin mbi shqyrtimin e ankesave nga Paneli Shqyrtues i KRPP-së të datës 10.10.2008 për periudhën kohore 01 Janar -30 Qershor 2008 .

Paneli shqyrtues i KRPP-së gjatë periudhës gjashtë mujore (01 Janar -30 Qershor 2008) ka pranuar dhe shqyrtuar 110 ankesa të palëve të interesuar- operatorëve ekonomik në të cilat pretendonin shkelje të ligjit në vendimet e Autoriteteve Kontraktuese gjatë vlerësimit të ofertave. Të gjitha këto ankesa kanë të bëjnë me 98 lëndë të prokurimit .

Për shqyrtimin e këtyre lëndëve paneli shqyrtues ka mbajtur 27 seanca. Prej gjithsejtë 110 lëndë të pranuar, 98 lëndë janë shqyrtuar. Vendime të aprovuara kanë qenë 24, rivlerësim 9 dhe vendime për anulim 33. Ndërsa numri i ankesave të pakompletuar të refuzuar ka qenë gjithsejtë 32.

Paneli shqyrtues i KRPP-së ne bazë të nenit 95.2 të LPP-së për periudhën gjashtë mujore (01 Janar -30 Qershor 2008) ka shqyrtuar gjithsejtë 19 vendime të APP-së, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kërkesat e autoriteteve kontraktuese për të autorizuar përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim te njoftimit për kontratë dhe revokim të nenit 30.A.4.

Kërkesa për autorizim të autoriteteve kontraktues për revokim të nenit 30.A.4 kanë qenë gjithsejtë nëntë (9), ku numri i vendimeve të vlefshme të APP-së ka qenë shtatë (7), dhe numri i vendimeve të pavlefshme ka qenë dy (2).

Kërkesa për procedurë të negociuar pa publikim te njoftimit për kontratë sipas nenit 34 ka qenë gjithsejtë 10, ku numri i vendimeve të vlefshme të APP-së ka qenë tetë (8) dhe numri i vendimeve të pavlefshme ka qenë dy (2).

III. OBJEKTIVAT E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2009

Ngritja e institucionit të OSHP-se gjatë vitit 2008 u shoqërua me një fluks të konsiderueshëm punësh. Synimet tona për vitin 2009 përfshinë vazhdimin e përpjekjeve për konsolidimin e institucionit, si nga pikëpamja strukturale po ashtu edhe nga organizimi i punës se OSHP-së,për konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit

me operatoret ekonomik dhe autoritetet kontraktuese, si dhe për zbatimin e strategjisë së komunikimit .

Konsolidimi i Institucionit

Numri i ankesave të paraqitura në Organin Shqyrtues të Prokurimit gjatë vitit 2008, me gjithë kohën e shkurtër të aktivitetit të institucionit e bënë të nevojshme që në vitin në vazhdim, në funksion të organizimit më të mirë të punës dhe përmbushjes së misionit, të rishikohet me sens zgjerimi, struktura dhe organika e OSHP-së, e cila duhet të mbështetet edhe me fondet përkatëse të buxhetit për vitin 2009.

Trajnimi i mëtejshëm i stafit, qoftë i karakterit të përgjithshëm apo të specializuar do të vazhdojë të mbetet një objektiv i rëndësishëm i punës në institucionin e Organit Shqyrtues të Prokurimit gjatë vitit 2009.

Nga pikëpamja e organizimit të punës, do të vazhdohet puna për dokumentet tjera funksionale, Rregullorja e punës së OSHP-së si dhe regjistri publik i ankesave dhe trajtimi i tyre.

Vënia e këtij informacioni në dispozicion të publikut do të mundësojë rritjen e transparencës mbi veprimtarinë e institucionit e për rrjedhojë dhe të besueshmërisë ndaj tij nëpërmjet ueb faqes së këtij organi e cila tashëm është hapur me datën 12.02.2009 në këtë adresë : www.ks-gov.net/oshp.

Një kujdes i veçantë do të kushtohet problematikës që do të identifikohet gjatë proceseve të hetimit të procedurave të prokurimit publik dhe dhënies me koncesion, që do të përbënë bazë për rekomandimet dhe propozimet për ndryshime dhe përmirësime që duhet të bëhen në legjislacionin e prokurimit publik dhe dhënies me koncesion në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara sipas dispozitave të LPP-së.

Zbatimi i strategjisë së komunikimit

Objektiv kryesor për OSHP-ën për vitin 2009, do të mbetet zbatimi i strategjisë së komunikimit, e cila synon zhvillimin e marrëdhënieve me publikun si një proces komunikimi të brendshëm dhe të jashtëm, realizim me angazhim të plotë i cili do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e efektivitetit dhe efijencës së punës së institucionit.

Në të njëjtën kohë do të thellojë zhvillimin e një dialogu konstruktiv dhe të bashkëpunimit të gjer me përfitime reciproke, me operatoret ekonomik, autoritetet kontraktuese, Agjensionin e Prokurimit Publik, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, me mediat, grupet e interesuara dhe publikun e gjere.

Organi Shqyrtues i Prokurimit do të ketë angazhim parësor për të forcuar marrëdhëniet me operatorët ekonomik me synim që ti informojë mbi shërbimet që i ofron në mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, duke inkurajuar mos tolerimin e favorizimeve dhe shkeljes së ligjit në procedurat e prokurimit publik apo të dhënies me koncesion dhe duke krijuar një sistem të sigurt të denoncimit të rasteve korruptive të tyre.

Ky angazhim do të synojë gjithashtu në informimin e tyre në mënyrë të rregullt dhe transparente për veprimtarinë e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe lehtësisht të monitorueshëm nga komuniteti i biznesit dhe publiku i gjerë për menaxhimin e ankesave dhe dhënien e vendimeve meritore nga ana e OSHP-së.

Ndër prioritetet e OSHP-së do të mbetet bashkëpunimi me autoritetet kontraktuese duke ofruar një marrëdhënie të hapur nën frymën e dialogut për një synim të përbashkët, në vendimmarrjen e drejt në përputhje me ligjin si për procedurat e prokurimit ashtu edhe të dhënies më koncesion, ku kritika konstruktive dhe këshillimi për përmirësimin janë pjesë të rëndësishme të procesit.

Viti 2009, do të jetë vit i parë i funksionimit të plot të OSHP-së dhe ne mirëpresim kërkesat nga Kuvendi për të raportuar mbi ecurinë e punës, pasi jo vetëm na keni mandatuar, por dhe kemi nevojë për mbështetjen e secilit prej jush për rekomandimet mbi ndryshimet të nevojshme ligjore në fushën e prokurimit publik dhe të dhënies me koncesion, të cilat dalin nga puna jonë, në zbatim të kompetencave që na keni miratuar, si një institucion i pavarur, kompetent, i pa anshëm në mbrojtje të drejtave të çdo operatori ekonomik.

Ju faleminderit për vëmendje

20 Shkurt 2009

Prishtinë

Kryetari i OSHP-së



Hysni Hoxha